



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 24.2.2015, e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinofci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviçiqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Agim Gashi (LDK) dhe Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi, kryesues.**

Para se të kalohej në diskutim të pikës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se ky propozimbuxhet është miratuar njëherë në Kuvend, mirëpo pas dërgimit në Ministrinë e Financave, përmes një shkrese na është konfirmuar se kemi kaluar kufijtë buxhetor, andaj kemi qenë të detyruara ta korrigojmë dhe ta sjellim përsëri në Kuvend për miratim.

U konstatua se u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Propozimbuxheti për vitin 2015.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se ky buxhet është në përputhje me qarkoren buxhetore të përgatitur nga Ministria e Financave, por është në s'përputhje me buxhetin i cili është votuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në afatin e përcaktuara me ligj. Buxheti prej 69 milionë eurove, është buxhet i cili projektton ambicie dhe zhvillim, është buxhet i cili në asnjë moment nuk e rëndon buxhetin qendror, sepse të hyrat e parapara shtesë prej 6 milionë eurove realizohen nga të hyrat vetjake. Ky propozimbuxhet, të cilin sot e kemi në shqyrtim, ndonëse nuk është në përputhje me nevojat e qytetit, nuk është buxhet i zhvillimit, është buxhet i cili trajton nevojat e qytetarëve të Prishtinës, por nuk është buxhet i cili është votuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, theksoi se edhe në votimin i cili është bërë në muajin shtator, LDK-ja i ka pasur vërejtjet e veta në buxhet, në kuptimin e planifikimit të të hyrave vetjake që kanë qenë ambicioze, kështu që ne si Grup parlamentar i kemi analizuar, i kemi bërë krahasimet me atë të vitit të kaluar që është miratuar, përpjesëtimisht janë zbritur këto nëpër kategori buxhetore, dhe e kemi një 27 milionë në të hyrat vetjake. Uroj që të mblidhen 27 milionë, që tejkalohet, andaj dhe ne do ta përkrahim dhe e votojmë këtë projektbuxhet.

Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së, shprehu mendimin se qëllimi është që të krijojmë një mirëqenie shumë më të mirë për qytetarët e Prishtinës, dhe nuk ka kuptim që për shkak të tekeve politike, të reduktohet një ambicie e çiltër, e mirë, e bazuar në punë, të cilën e ka projektuar buxheti i Komunës dhe e ka miratuar në këtë Kuvend komunal. Reduktimi i grantit qeveritar për 5 milionë euro në çështjen e shërbimeve, është një absurd i paparë dhe është problem i madh për këtë qytet. Nëse ne u shërbejmë 350.000 qytetarëve dhe paguhemi vetëm për 200.000 qytetarë, atëherë nuk mund të kemi përmirësime të shërbimeve për të cilat aspirojmë. Me miratimin e këtij buxheti, nuk po shprehet miratimi i politikës së Shpendit, por është frika se mosmiratimi i këtij buxheti do të sjellë zgjedhje në këtë kryeqytet dhe ato zgjedhje do ta dëmtonin LDK-në.

Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, fillimisht shprehu shqetësim rreth kësaj pike, duke thënë se pse u tërhoq ky projektbuxhet nga rendi i ditës të mbledhjes së kalua të KPF-së. Nga kjo ndihem i mashtruar, sepse është thënë se po tërhiqet për të marrë disa interpretime, dhe ne kemi menduar që po kërkohen interpretime rreth vijave buxhetore. Sa i përket buxhetit, pajtohemi që ai duhet të jetë më i madh, pajtohemi që kryeqyteti do të duhej të kishte projektbuxhet ambicioz, por pikërisht ambicia i mungon këtij projektbuxheti, nuk shoh ndonjë projekt të madh i cili do të më dukej ambicioz, përveç shifrave si numër.

Ne e përkrahim që buxheti të jetë më i madh, natyrisht, por do të ishim shumë më të fortë, më të fuqishëm në kërkesën tonë, sikur ta realizonit buxhetin e vitit të kaluar.

Mirlinda Sopi, në emër të GP të AKR-së, tha se tendenca jonë si GP, ka qenë që Prishtina të jetë në shërbim të qytetarit dhe të jetë më mirë sesa që ka qenë. Këtë projektbuxhet e kemi analizuar mirë dhe me të gjitha ato cungime dhe këto largime të buxhetit, ne qoftë si asamblistë, qoftë edhe si subjekt politik, kemi për qëllim që Komunën ta qojmë përpara, që qyteti apo Komuna të jetë në shërbim të qytetarit. Këtë projektbuxhet do ta përkrahim për miratim.

Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, tha se edhe ne e kemi analizuar këtë planifikim të buxhetit. Buxhetin e miratuar nga ky Kuvend e kishte kthyer Ministria si rezultat i tejkalimit të kufijve buxhetorë. Tani, pavarësisht se i njëjti buxhet do të jetë në s'përputhje me kërkesat qytetare, sepse numri i qytetarëve në Prishtinë është më i madh sesa numri që doli nga regjistrimi i popullsisë, për hir të një konstruktiviteti që ky Kuvend mos të bllokohet, ne do ta përkrahim këtë buxhet.

Si subjekt politik, kemi një propozim konkret lidhur me paranë publike. Propozojmë që në bashkëveprim me mekanizmat ekzekutiv të Komunës, të ndahen asamblistët në dy gupe, ata që punojnë dhe ata që nuk punojnë, dhe ne do të heqim dorë prej paushalit dhe benifiteve të buxhetit komunal për periudhën sa do të jemi në këtë këshill. Ky do të jetë shembull i mirë që të përcillet edhe në asambljetë tjera, madje edhe në nivel qendror.

Feti Mhediu, shef i GP të PD-së, theksoi se sa i përket këtij propozimi për këtë buxhet, ne e kemi përkrahur edhe buxhetin real që është paraqitur këtu më herët. Megjithëse ne kemi vërejtje, që Ministria duhet të jetë më këmbëngulëse, t'i shoh gjërat reale nëpër komunat e veta. Ne këtë buxhet do ta përkrahim, do ta miratojmë, por kam një sugjerim konkret në këto vijat buxhetore, konkretisht për shpenzimet e varrimit. Dua të dijë se a është bërë harmonizimi i subjekteve fetare që janë në Prishtinë, për shkak se ekzistojnë disa bashkësi fetare, andaj domosdo duhet të jetë një harmonizimin i tyre me ndërmarrjen "Hortikultura".

Brahim Mehmetaj, shef i GP të LB-së, u shpreh se, edhe pse e dimë që ky buxhet është i cunguar, ku ka pasur vend dhe mundësi të tjera që të zhvillohen dhe të jepen mundësi për buxhet më të lartë, duke e pasur parasysh se është kryeqytet dhe është një prej qyteteve më të mëdha në Kosovë, me nevojë dhe me mundësi më të mëdha, do ta përkrahim për votim. Njëherësh pajtohem me propozimin e dhënë nga subjekti politik AAK, rreth heqjes dorë nga paushali dhe benifitet nga buxheti komunal për periudhën sa do të jemi në këtë këshill.

Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politikë PF shprehu shqetësim, duke thënë se përgjithësisht vendimet që merren në Kuvend, janë kryesisht vendimet partiake, që nuk bazohen shumë në pikën që po diskutohet, por në pasoja që ajo pikë mund t'i ketë në pushtetet e atyre partive. Arsyetimi për zvogëlimin e buxhetin është arsyetim banal.

Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimbuxhet për vitin 2015.

Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS, u shpreh në përkrahje të miratimit të projektbuxhetit.

Sadri Ramabaja theksoi se buxheti i miratuar në leximin e parë në këtë asamble, ishte produkt i politikave progresive zhvillimore, kështu është konstatimi i pranuar pak a shumë nga shumica. Varianti që po imponohet te asamblistët sot, ka tendenca të hapura për trajtimin e kryeqytetit të Republikës së Kosovës si peng politik.

Ky buxhet që është sjellë sot, është produkt i politikave krejtësisht regresive dhe bllokuese, që po ushtron pushteti qendror me ndihmën e diktatit të numrave që ka këtu. Është në s'përputhje me nevojat e qytetarëve, dhe kjo pranohet përgjithësisht çoftë nga opozita, çoftë nga pozita, dhe po i imponohet kryeqytetit çuditërisht nga opozita. Ky buxhet është *sui generis* dhe si i tillë për mua mbetet parimisht i paarsyeshëm dhe i papranueshëm.

Shefki Gashi tha se kjo seancë nuk është dashtë të jetë e jashtëzakonshme, por është dashtë të jetë e rregullt, me aprovuar buxhetin, i cili detyrimisht është dashur të përsëritet, dhe të ju tregojmë të gjithëve se Prishtina është më e rëndësishme sesa asambleja e Komunës, më e rëndësishme se Kryetari i Komunës, qeveria komunale, për fat të keq, më e rëndësishme edhe se unë! Ka pasur mjete, ku të gjitha kanë qenë të zotuara, të kontrakturara, të filluara punimet dhe tani kemi një gjendje krejt tjetër. Uroj që edhe këto planifikime që janë bërë të realizohen, e kur të tejkalohen, do të bëjmë rishikim dhe do ta miratojmë prapë, sepse është interesi i të gjithë neve.

Pas të gjitha diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim projektbuxhetin për vitin 2015.

Me shumicë votash, dyzet e dy (42) vota për dhe pesë (5) kundër, u miratua Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2015- 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.